

Neni 6

Ngarkohen strukturat e Inspektoratit të Mjedisit, të Institutit të Shëndetit Publik, strukturat vendore të shëndetit publik, njësitë e qeverisjes vendore, prefektet e qarqeve dhe Policia e Shtetit për zbatimin e këtij akti normativ.

Neni 7

Moskryerja e detyrës së ngarkuar nga punonjësit e strukturave të përcaktuara në nenin 2 të aktit normativ, konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore dhe përbën shkak për fillimin e procedurave të largimit nga detyra.

Neni 8

Pika 3.1. e vendimit nr.587, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”, shfuqizohet.

Neni 9

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 445, datë 11.7.2012

PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 111 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1996 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat në caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj të jetë 21 000 (njëzet e një mijë) lekë.
2. Paga bazë minimale, mujore, jepet për 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës.
3. Paga bazë minimale orare të jetë 121 (njëqind e njëzet e një) lekë.
4. Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë.
5. Vendimi nr. 527, datë 20.7.2011 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha